


*Adhurimi Eukaristik*

**XXXIV e Diele Gjatë Vitit A**



# Krishti Mbret

*Famullia*  
*Katedralja e shën Palit - Tiranë*

**NË EMËN TË ATIT, E TË BIRIT E TË SHPIRTIT SHEJT.  
AMEN.**

Vëllazen e motra, tashma e shohim se sa ma shumë që kalojnë vitet, aq ma shumë duket sikur njeriu e zotnon botën me zbulimet e njëpasnjëshme dhe duket sikur don të japë mesazhin se nuk ka nevojë për Zotin. Ndërsa na jena këtu në gjunjë përpara Mbretit të gjithësisë për me u lutë për vetveten dhe për botën që të kuptojmë se pa Jezusin bota nuk mundet me ba kurrgjë! I krishteni i cili bashkëjeton me njerëzit e tjerë në këtë botë, duhet me dhanë dëshminë e lidhjes së ngushtë mes realiteteve njerëzore dhe të vërtetave të besimit në Jezu Krishtin. E vërteta e Jezu Krishtit i prekë drejtë për drejtë ndërgjegjet e të gjithë njerëzve, dhe nëpërmjet ndërgjegjes së tyre, kjo e vërtetë arrin deri tek i gjithë krijimi, duke ba që njeriu të ndihet i lirë në jetën e vet, pasi peshën e mëkatit e ka marrë vetë Mbreti i jonë përmbi vetveten e tij.

***Aleluia, aleluia.***

*“Kjoftë bekue ai që vjen në emën të Zotit!*

***Aleluia, aleluia.***

***Prej Ungjillit sipas shën Mateut (Mt 25, 31-46)***

Në atë kohë, Jezusi u diftoi dishepujve të vet këtë shëmbëlltyrë: “E kur të vij Biri i njeriut në madhësinë e vet e me të gjithë engjëjt, do të ulet mbi fronin e vet të madhnueshëm. Atëherë para tij do të mblidhen të gjithë popujt dhe ai do t’i ndajë njërin prej tjetrit, sikurse bariu ndan delet prej cjepeve. Delet do t’i vërë në të djathtën e vet e cjeptë në të majtën.

Atëherë Mbreti do t'u thotë atyre që do të jenë në të djathtën e tij: 'Ejani të bekuarit e Atit tim! Merrni në pronë Mbretërinë e cila u bë gati për ju që prej fillimit të botës! Sepse pata uri e më dhatë të ha, pata etje e më dhatë të pi, isha shtegtar e më përbujtët, isha i zhveshur e më veshët, i sëmurë e erdhët të më shihni, isha në burg e erdhët tek unë.'

Të drejtët atëherë do t'i përgjigjin: 'Zotëri, kur të pamë të uritur e të dhamë të hash, të etun e të dhamë të pish? Kur të pamë shtegtar e të përbujtëm, të zhveshur e të veshëm? Ose, kur të pamë të sëmurë ose në burg e erdhëm te ti?' Mbreti do të përgjigjet: 'Për të vërtetë po ju tham: çkado batë për njanin ndër këta vëllazen të mi më të vegjël, e batë për mue.'

Pastaj do t'u thotë edhe atyre që do të jenë në të majtën: 'Ikni prej meje, të mallkuar, në zjarr të pasosur, të përgatitur për djallin e për engjëjt e tij! Sepse isha i uritur e nuk më dhatë të ha, isha i etshëm e nuk më dhatë të pi, isha shtegtar e nuk më përbujtët, isha i zhveshur e nuk më veshët, i sëmurë dhe në burg e nuk erdhët tek unë.'

Atëherë edhe ata do t'i përgjigjen: 'Zotëri, kur të pamë të uritur, a të etshëm, a shtegtar, a të zhveshur, apo të sëmurë, ja në burg e nuk t'u gjetëm në nevojë?' E ai do t'u përgjigjet: 'Për të vërtetë po ju them: çkado s'batë për njanin prej këtyne më të vegjëlve, nuk e batë për mue.'

Këta do të shkojnë në mundim të përjetshëm, kurse të drejtët në jetën e pasosur."

***Fjala e Zotit***

*Heshkje meditimi...*

Çdo i krishtenë duhet me e kuptue në mënyrë sa ma të drejtë lidhjen e ngushtë mes tij dhh Krishtit, ashtu sikurse flitet në Ungjillin të cilin sapo e lexueme. Unë mendoj se do të duhej me e edukue shumë vetveten në këtë drejtim sepse shumë prej nesh nuk mbrijnë me e kuptue dhe me e pa se në çfarë mënyret Krishti bahet dhe asht i pranishëm në jetën e tyne. Vetëm kur ta kuptojmë sesi dhe në çfarë mënyret Krishti asht i pranishëm në jetën tonë, vetëm atëherë dëshmia e jonë ka më shkëlqye në krejt të vërtetën e vet, dhe vetëm atëherë edhe vetë jeta e jonë ka me pasë gëzimin e të jetuemit me shpresën e shëlbimit por dhe me paqen që aq shumë e dëshirojmë, pavarësisht vështirësive që mundena me hasë në të përditshmen tonë. Dashnia për njeriun mund të mësohet dhe të bahet pjesë e jetës sonë, vetëm në kjoftë se kjo dashni e ka burimin dhe mbarimin në dashninë që kena zbulue se Krishti ka për ne dhe ne për Krishtin.

*Heshtje meditimi...*

**Zoti është bariu im,  
asgjë nuk më mungon.  
Më kullotë në fushat e gjelbra,  
më prin në ujëra të qeta,  
shpirtin ma përtërin.**

**Ai më prin shtigjeve të drejta  
në saje të dashurisë së Emrit të vet.**

**Po edhe në kalofsha  
nëpër luginën e hijes së vdekjes,  
s'trembem nga e keqja**

**sepse ti je me mua:  
thupra jote dhe kërraba  
për mua janë ngushëllim.**

**Ti ma shtron tryezën përpara  
ndër sy të armiqve të mi,  
me vaj erëmirë kryet ma lyen,  
gotën ma mbush plot e përplot.**

**Hiri dhe mirësia do të më përcjellin  
në të gjitha ditët e jetës sime,  
do të banoj në shtëpinë e Zotit  
derisa të jem gjallë.**

*Heshtje meditimi dhe këngë...*

Festa e Krishtit Mbret asht një festë e cila për vetë emnin që ka, mundet edhe me krijue ndonjë keqkuptim shpirtnor. Por asht Shkrimi i Shejtë dhe në veçanti Ungjilli që na skjaron të vërtetën dhe thelbin e këtij titulli. Në Ungjill Jezusi asht një mbret i çuditshëm i cili përfshihet dhe përzihet me vuejtjen e botës.

Ajo çka përshkruhet në këtë pjesë Ungjillit nuk asht thjeshtë një direktivë morale sesi duhet me u sjellë, por asht thelbi i kuptimit të historisë, thelbi i vlerës së gjesteve tona njerëzore, kjo sepse pikërisht tani dhe në këtë tokë e në këtë moment asht në lojë fati i jonë i nesërm.

Na bajmë që të rritet Mbretëria e Hyjit, e bajmë ma njerëzore historinë tonë atëherë kur zgjidhim problemin e të uritunve, problemin e të lanunve mas doret, pra atëherë kur i shtrijmë hapsinat e drejtësisë, të mëshirës dhe të dashnisë.

Kultura e botës së sotme në të cilën jetojmë asht një kulturë e retorikës dhe e demagogjisë: Flitet për të drejta të njeriut dhe për sisteme të përsosuna, por në të vërtetë ka njerëz që vdesin për një copë bukë.

Këto janë mëkatet që Ungjilli i dënon.

Mbretëria e Hyjit ka një logjikë tjetër: nuk ka pra logjikën e projekteve të mëdhaja demagogjike, por logjikën të bamit diçka “tani” dhe “sot”, logjikën e gjesteve të përditshme. Me i dhanë apo me ja mohue pak ushqim, pak ujë, pak kohë, pak rroba, “tani” dhe “sot”; ky gjest merr një vlerë të përjetshme. Përballja përfundimtare asht mes atij që ka uri dhe atij që e shuan apo nuk e shuan këtë uri. Në këtë vepër, jo vetëm shihet një veprim moralisht i denjë, por edhe mundësia për me njoftë Misterin e Zotit.

Na shpeshherë besojmë se e njohim, besoj se po jetojmë me Zotin dhe besojmë se kena edhe familjaritet me Të kur jena në Kishë në adhurim, në Meshë apo edhe kur vizitojmë Kishën ne çdo orë të ditës. Por, sapo dalim në rrugë, në zemër të jetës së përditshme, dhe kur ndeshemi me të vërtetën e asaj që Zoti na kërkon, atëherë e kena të vështirë për me e përballue jetën tonë dhe besimin tonë me vuajtjen e të tjerëve. Shpeshherë na pëlqen që të mos përzihena me dramën e jetës së të afërmit tonë.

Në këtë pikë, Ungjilli që sapo lexuem na i hapë sytë dhe na thotë se vendi ku mund ta takojmë Zotin asht pikërisht uria, etja, braktisja, burgu, shtrati i spitalit, pra vetmia dhe mjerimi i njerëzve. Jezu Krishti duke ardhë në këtë botë ka marrë mbi vetvete pikërisht këto realitete dhe don me kenë i identifikuem pikërisht me këto realitete.

Kjo asht njohja themelore që mund të arrijmë te Zoti. Asht edhe një njohje tjetër, njohja intelektuale, për të cilën Ungjilli

nuk ka në të vërtetë të njajtin vlerësim Jezusi thotë:

*«Të falënderoj, o Atë, Zot i qiellës e i tokës, sepse jua ke mshehë këto gjana të dijshtëmëve e krenarëve dhe jua ke zbulue të vegjëlive dhe të përvujtunve».*

Kjo sepse komentet e studiuesve në të vërtetë ta kënaqin inteligjencën, por ja hjekun shpeshherë falës së Ungjillit forcën e vërtetë vepruese. Asht vuetja e njeriut që Fjalën e ban të mprehtë dhe vepruese.

Në këtë mënyrë takimi me njeriun që vuen mund të bahet rruga për takimin me Hyjin dhe rruga për rritjen tonë njerëzore.

Ka një të veçantë shumë të randësishme në këtë dialog: të drejtët thojnë nuk e kanë ba të mirën pse paskan pa Zotin, por e kanë thjesht pse kanë pa nevojën e njeriut. Kjo mund të shpjegohet vetëm duke e pa dashninë si vepruese në sajë të natyrës së saj dhe domosdoshmërisht me pasë motivin fetar të besimit në bazë të sjelljeve tona. Don me thanë për me ju bind instinktit që kena në vetvete për me ba të mirën, pa pretendue dokumentin e identifikimit të të afërmit që ka nevojë.

Kjo lloj intuitet përdoret tash përballë pjesës tjetër, përballë atyne që nuk janë të aftë për me kenë minimalisht të njerëzishëm:

*«Nuk e dijshtëm se ti identifikohesh në të varfnit».*

«Mos dija» mundet me kenë një lloj justifikimit në fushën e njohjeve intelektuale, por jo në fushën e Dashnisë. Kur marrim vesht se dikush ka uri dhe etje, apo asht i shveshun, atëherë dijmë gjithçka që asht e nevojshme për me ditë. Nuk asht e nevojshme për me njoftë teologjinë, për me dashtë me vu në praktikë dashninë.

Prej Fjalëve të Zotit tonë del në pah edhe një mësim i madh i cili na jep zemër me veprue përtej shkurajimit që mund të nxisë në ne konteksti shoqnor në të cilin jetojmë.

Mbretnia e Hyjit mund të ndërtohet dhe asht e bazueme përmbi kritere njerëzore, pra mund të dertohet duke u bazue përmbi gjeste të solidaritetit të përditshëm. Duke kenë kështu e vërteta, atëherë të gjithë jena të thirrun për me kenë protagonistë të ndërtimit të kësaj Mbretnie, Mbretni e cila nuk duket shumë e pranishme në mesin tonë, por që në fund të fundit asht fati i çdo njeriu.

Pikërisht bë këtë mënyrë Jezusi i Nazaretit bahet Zot dhe frymëzues i historisë. Kjo asht dhe kështu duhet me u kuptue mbretnimi i Krishtit.

Ti kërkojmë Zotit hirin që të mundena me e kuptue thirrjen tonë si të krishtenë, në mënyrë që të mos e lajmë me vdekë shpresën historike që edhe sot e kësaj dite Ungjilli ja jep botës, pikërisht kësaj bote e cila duket sikur jeton gjithnji e ma shumë nën peshën e zhgënjimit dhe të dështimit.

*Heshtje meditimi...*

Të lutemi të gjithë bashkë:

**O Zot Jezu Krisht,  
o Mbreti im dhe gjithçka e imja,  
të dua me gjithë forcën time,  
të adhuroj me gjithë zemrën time,  
dhe me krejt qenien time  
të shpalli si Zotin tim dhe Hyjin tim.  
Këtë të vërtetë që ndjej  
dua të ta them në çdo moment të jetës sime,  
edhe pse shpesh ta them me zë të dobët,  
sepse e di se jeta ime,  
nuk është shpesh në sintoni me fjalët e mia.**



**Fatkeqësisht shpeshherë e kam dëshmuar  
se me ty jam gënjeshtar/e,  
nganjëherë për të mos i lënduar vëllezërit,  
por më shpesh jam gënjeshtar/e  
për arsye të dobësisë dhe krenarisë sime.**

**Më fal, o Zot Jezus,  
më fal dhe më ndihmo në këtë dobësi.  
Më ndihmo ta shpalli si duhet Mbretërinë tënde,  
më shumë me vepra sesa me fjalë;  
më shumë duke të të shërbyer në nevojtarët  
sesa duke qëndruar në tempullin e gurit;  
më shumë duke të të dashur në përvujtëri  
sesa duke të të shpallur me mendjemadhësi.**

**Unë e ndjej se:**

**Ky është mbretërimi që ti dëshiron,  
e ndërkohë unë dua të jetoj i gëzuar,  
duke pritë për ta shikuar fytyrën tënde,  
dhe për të jetuar deri në amshim,  
i lumtur dhe i dashuruar me ty. Amen.**

*Heshtje meditimi dhe kangë...*

*«Ejani, të bekuemt e Atit tem».*

Në festën e Krishtit Mbret, kjo pjesë e Ungjillit të shën Mateut e cila pra asht e vendosun në fund të vitit liturgjik, duket sikur ju jep një përgjigje përfundimtare të gjitha shëmbëlltyrave që Jezusi i kishte diftue për Mbretninë.

Këtë herë Jezusi nuk përdorë ma metafora, por difton masën matëse me të cilën kena me u matë në gjykimin përfundimtar «kur Biri i njeriut do të vijë në lumninë e tij».

Kur të ulet përmbi fronin e Hyjit, Jezusi Mbret ka me i nda të drejtët prej të të gjithë të tjerëve duke ju dhanë pikërisht të drejtëve Mbretninë që jua kishte premtue.

Motivet që janë në themel të fitimit të Mbretnisë së Hyjit janë: «Kam pasë uri dhe me keni dhanë me hanger...», na vijnë qysh prej Besëlidhjes së Vjetër: me ju dhanë me hanger të uriturve, me ju dhanë me pi të etshmve, me veshë të zhveshunit, me strehue shtegtarët dhe me pa të sëmurët.

Megjithëkëtë janë dy gjana themelore të cilat përcaktojnë hymjen në Mbretninë e përgatitun për ne qysh prej krijimit të botës.

Së pari, Mbretnia asht për të tanë njerëzit pa dallim rracet apo kulturet: Përpara Krishtit Mbret «do të grumbullohen të gjithë popujt»; Kjo don me thanë se Ungjilli dhe e vërteta e tij nuk asht vetëm për popullin e zgjedhun dhe as vetëm për disa individë të veçantë, por për krejt popujt, për një Kishë, për një bashkësi, për një popull që asht populli i të drejtëve të cilët janë angazhue për me ndërtue një botë ma të mirë, dhe për këtë arsye kanë me kenë edhe të bekuem prej Atit.

Të jesh i krishtenë ma së parit asht një zgjedhje personale, por nuk mundet me u ndalë vetëm aty; na jena të krishtenë edhe si bashkësi e për këtë motiv duhet me luftue së bashkut duke ndërtue struktura drejtësiet që e kundërshtojnë sistemin që vetëm prodhon uri, etje dhe vetmi.

Gjaja tjetër e randësishme që duhet me u kuptue asht kjo: Veprat e dashnisë nuk duhet me i ba me qëllimin kryesor të të marrunit të një shpërblimit nga Zoti, por duhet me i ba sepse na burojnë prej zemrës, dhe prej një zemre e cila kupton se Zoti

ma përpara i ka ba të mira.

Kushdo që e don të afërmin e vet sikurse vetveten, ai asht duke dashtë Zotin, edhe në kjoftë se nuk e ka njoftë Jezusin:

«O Zot, por kur të kena pa të uritun?».

Mrekullia që shprehet në këto fjalë, të cilat i thojnë kjoftë të drejtët ashtu edhe të tjerët, dojnë me na thanë se vetëm dashnia pa qëllime të dyta, u jep vlerë veprave tona, sepse «Zoti asht dashni», dhe vetëm ai që don mundet me e njoftë Hyjin:

*«Gjithçka që ja keni ba njanit prej këtyne vëllazënve të mi të vegjël, ma keni ba mue».*

Ndërsa kush nuk ka dashni, kush nuk ka mëshirë për të afërmin, nuk e ka njoftë kurrë Zotin dhe në këtë mënyrë ja dhuron vetë vetvetes një jetë të pakuptimtë dhe të paqëllim në vetvete. Njeriu që nuk ka dashni, nuk ka me e pasë kurrë gëzimin për ta zbulue fytyrën e atij që ka uri, të atij që ka etje, të atij që asht i zhveshun, të atij që asht i huaj, të atij që asht i sëmurë, të atij që asht në burg; nuk ka me pasë gëzimin për me e pa fytyrën e Krishtit të Ringjallun, i cili fitimtar mbi vdekjen, na del në takim çdo ditë në personin e vëllazënve të tij ma të vegjël duke na kërkue ndihmë për ta shndërrue këtë botë në një Mbretni Dashnie e Drejtësie, në të cilën dëshiron që të gjithë të bijtë e tij të ndjehen të barabartë në pritje të Ardhjes së Mbretnisë përfundimtare të Tij.

*Heshtje meditimi...*

Të lutemi të gjithë bashkë...

**Qofsh bekuar, o Zot Jezu Krisht,  
Mbreti ynë dhe paqja e jonë!  
Je ti Bariu i Mirë  
që na përcjellë në burimin e jetës;  
Je ti Bariu i Mirë,  
që kujdesesh për mua kur jam i lodhur,  
duke e mbajtur mbi shpatullat e tua,  
mua dhe çdonjërin nga ne,  
kur nuk kemi forcë për të ecë përpara.  
Qofsh bekuar, o Zot Jezu Krisht,  
Mbreti ynë dhe udhëheqësi e jonë!  
Sepse ti je Fjala që na përshkon  
deri në thellësi të zemrës sonë,  
duke na ndriçuar në jetën tonë,  
duke na i zbuluar të këqijat tona  
dhe duke na ofruar  
ilaçin e mëshirës dhe të faljes tënde,  
në shpresën e dashurisë tënde të pafundme.  
Qofsh bekuar, o Zot Jezu Krisht,  
Mbreti ynë dhe Mbreti i gjithësisë!  
Je ti Miku dhe Shoku  
i të vegjëlve dhe të varfërve,  
sepse Ti je i strehuar në çdo njëri të vogël,  
sepse ti je i dashuruar me çdo njeri të varfër.  
Ty të qoftë lavdi dhe nder përherë,  
o Mbreti ynë dhe Bariu i jonë!**

*Heshtje meditimi dhe kangë...*

## **Ati ynë...**

O Zot Jezu Krisht, na jep hirin që castin e gjykimit përpara teje ta presim me gëzim dhe pa frikë. Në atë cast, ti o Jezus, do ti habitësh të gjithë njerëzit, sepse njeriu ndoshta nuk e pret që në PROVIMIN E JETËS, pyetjet tuaja nuk do të kenë lidhje me liturgjinë e lavdeve që të kemi thurur me fjalë, por ata do jenë pyetje që për kryefjalë do të kenë dashninë dhe solidaritetin, urinë dhe etjen, strehimin dhe veshëmbathjen, spitalin dhe burgun. Në atë ditë të gjykimit tand, o Jezus, edhe përsëri ndoshta do ti dëshirosh, por për ne nuk do të ketë ma kohë për tu shfajësue. Nuk do të mundena ma me u shfajësue duke thanë: Nuk e dija, nuk e mendoja kështu, nuk të kam pa, nuk të kam njoftë, nuk e kam kuptue se ishe ti... Fjalët tona nuk do të munden ma me e mshehë ngurtësinë dhe mendjemadhësinë e zemrës tonë, egoizmin apo grykësinë që i ka frymëzue zgjedhjet tona të jetës. Në atë ditë, Gjykimi i yt, o Jezus, do të bajt që përreth teje të jenë ato njerëz të cilët unë ndoshta i kam mendue shumë larg prej Mbretnisë tande, e ndërkohë që ndoshta jashtë kanë me mbetë profesionistat e fesë bashkë me gjestet e tyne të devotshmërisë hipokrite.

*Heshtje meditimi...*

Të lutemi të gjithë bashkë:

Lutja për thirrjet meshtarake

**Të dëgjueshëm ndaj Fjalës tënde,  
të kërkojmë o Zot:**

**“Dërgo punëtorë në të korrat e tua”.**

**Në lutjen tonë**

**Ti e sheh nevojën për meshtarë të rinj.**

**Dhuroju të rinjve tanë,**

**një shpirt të hapur dhe plot guxim,  
që ta pranojnë ftesën tënde.**

**Foli me zemrën Tënde zemrës së tyre  
dhe thirri për emër.**

**Në sajë të hirit tënd**

**le të jenë, të qetë,**

**të lirë dhe të fortë;**

**të lidhur me një dashuri të vetme,**

**të pastër dhe besnike.**

**Të jenë apostuj të apasionuar të Mbretërisë tënde,**

**kundërshtarë të hipokrizisë**

**dhe heronj të përvujtë të Shpirtit.**

**Edhe një gjë tjetër të kërkojmë, o Zot:**

**bashkë me të “thirrurit”**

**të mos mungojnë edhe “ata që i thirrin”;**

**ata që në emrin tënd i ftojnë,**

**i këshillojnë, i shoqërojnë dhe i udhëheqin.**

**Qofshin famullitë tona shenja të bekimit tënd**

**dhe hapësira të denja**

**në të cilat mësohet dhe shpallet besimi.**

**Për seminaristët tonë të kërkojmë**

**qëndresë në zgjedhjen e tyre:**

**bëj që të rriten çdo ditë në shejtëri dhe në dije.  
Ata që tashmë e jetojnë thirrjen tënde,  
Ipushkvin tonë dhe Meshtarët tanë  
- forcoji në punën e tyre apostolike,  
mbroji në ankthet e tyre,  
ruaji në vetminë e tyre,  
dhe forcoji në besnikëri.  
Me ndërmjetësinë e Nënës tënde të Shejtë,  
po ta besojmë ty, o Jezus, lutjen tonë.  
Lindshin, o Zot, prej lutjeve tona,  
thirrjet meshtarake  
për të cilat aq shumë kemi nevojë. Amen.**

*Heshtje e shkurtë dhe kanga e Sakramendit*

**Sakramend pra kaq t'madhnuem,  
le t'adhrojmë me f'tyrë për dhe,  
edhe dokja e motit t'shkuem  
t'ia lshojë rendin sjelljes s're;  
N' çka s'mbrrin mendja me kuptue,  
Ndhimë t'na bahet shejtja fe.**

**Atit, Birit sot përhera  
u kjoftë kanga plot hare,  
jetë pushtet u kjoftë e ndera  
bekue kjoshin n'qiell e n'dhe;  
Shpirti rrjedhë dy vehtjesh tjera,  
njai kjoftë lavdi i shejtes fe. Amen.**

- Bukën qiellore ua dha atyre.
- Që në vetvete ka çdo shije.

**Të lutemi.** O Zot Jezu Krisht, që në Sakramendin e mrekullueshëm të Eukaristisë na ke lanë përkujtimin e Pashkëve të tua, ban që ta adhurojmë me fe të gjallë misterin e shejtë të Korpit dhe Gjakut tand, për të shijue në ne të mirat e shëlbimit tand. Ti që jeton e mbretnon në shekuj të shekujve. Amen.

*Bekimi me të Shejtnueshmin Sakramend*

*Litanitë e Emnit të Zotit*

**Qoftë bekuar Zoti.**

**Qoftë bekuar emri i shejtë i Tij.**

**Qoftë bekuar Jezu Krishti,**

**Zot i vërtetë e njeri i vërtetë.**

**Qoftë bekuar emri Jezus.**

**Qoftë bekuar zemra tejet e shejtë e Tij.**

**Qoftë bekuar gjaku tejet shejtë i Tij.**

**Qoftë bekuar Jezu Krishti**

**në Sakramendin tejet shejtë të Elterit.**

**Qoftë bekuar Shpirti Shejtë ngushëllues.**

**Qoftë bekuar e madhnueshmja Nana e TenZot,**

**Virgjëra Mari.**

**Qoftë bekuar të zanët e shejtë e të panjollë të saj.**

**Qoftë bekuar të ngjiturit e lumtur të saj në qiell.**

**Qoftë bekuar emri i Zojës Virgjër dhe Nanë.**

**Qoftë bekuar shejti Jozef, fati tejet i pastër i saj.**

**Qoftë bekuar Zoti ndër engjëjt dhe shejtnit e vet.**

*Kanga përfundimtare.*